



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 03.12.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, , Fatmir Xhelili, Daut Haradinaj, Aida Dërguti, Ismet Beqiri, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi, Xhelal Sveçla, Zoran Mojsilović, Fadil Beka, Bahrim Shabani

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala , kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
 2. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes;
 3. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
 4. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
 5. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Të ndryshme

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes.

Kryetari, theksoi se pas përfundimit të punës së grupeve punuese, propozim amendamentet janë proceduar për mendim në komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, për të cilat janë kthyer të gjitha mendimet dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje. Andaj propozoi që të hidhet në votim raporti me propozim amendamente.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime të deputetëve prezent nxori këtë:

REKOAMNDIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes procedohet për në Kryesinë Kuvendit dhe rekomandohet procedimi në seancë plenare dhe votimi i tij.

3. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, theksoi se edhe për këtë projektligj nuk ka pasur asnjë vërejtje nga komisionet e përhershme të Kuvendit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, me vota unanime të deputetëve prezent nxori këtë:

REKOAMNDIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës procedohet për në Kryesinë Kuvendit dhe rekomandohet procedimi në seancë plenare dhe votimin e tij.

4. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, theksoi se edhe për projektligj nuk ka asnjë vërejtje nga komisionet e përhershme.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendi të ditës, me vota unanime të deputetëve prezent nxori këtë:

REKOAMNDIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës procedohet për në Kryesinë Kuvendit dhe rekomandohet procedimi në seancë plenare dhe votimi i tij.

5. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kryetari, theksoi se edhe për këtë projektligj janë dhënë opinionet nga Komisionet e përhershme. Para hedhjes në votim, fjalën ia kaloi z.Fatmir Xhelili, kryesues i grupit punues.

Fatmir Xhelili, theksoi se Projektligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i gatshëm të procedohet për lexim të dytë, po ashtu theksoi se nga puna e grupit punues, kanë dal gjithsej dyzet amendamente. Propozoi që para se të hidhet në votim të tërhiqet një amendament, është fjala tek Nenin 59, të mbetet siç ka qenë në fazën fillestare dhe kërkoj përkrahjen e anëtarëve të Komisionit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendi të ditës, me vota unanime të deputetëve prezent nxori këtë:

REKOAMNDIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale miratohet me propozimin e kryesuesit z.Fatmiri Xhelili dhe procedohet për në Kryesinë Kuvendit dhe rekomandohet procedimi në seancë plenare dhe votimin e tij

6. Të ndryshme

Kryetari, njoftoi që mbledhja e planifikuar për nesër, shtyhet për javën tjetër, pasi Ministri i Punëve të Brendshme nuk është në Kosovë.

Daut Haradinaj, kërkoj që para se të vijë në raportim Ministri, ti kërkohet me shkrim lidhur me masat e ndërmarra për vjedhjet e shumta që kanë ndodhur në Kosovë këto ditë e fundit. Gjithashtu edhe çështje tjetër është edhe përdorimi i drogave në shkolla, nëse kanë marrë masa

apo nëse kontrollohen për këtë çështje. Po asht kjo çështje duhet të merret si apel publik luftimi i fenomenit kundrejt përdorimit të narkotikëve në shkolla

Fatmir Xhelili, theksoi se pajtohet me propozimin e z.Haradinaj, duke kërkuar që Komisioni të rekomandoj që të bëhet koncentrimi i efektivave të policisë kundrejt grupeve që plaçkitin, pasi është rritur frika e qytetarëve.

Kryetari, propozoi që sa i përket punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës, të ketë një përmbyllje të këtij raporti, nëse kanë përfunduar të gjitha takimet, në mënyrë që të procedohet në seancë.

Rexhep Selimi, në cilësinë e kryesuesit theksoi se për shkak të angazhimeve në projektligjet e FSK-s, ky proces është zgjatur pak, por që në ditët në vijim sipas rrjedhës së punës së Kuvendit do të procedohet për seancë.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala